REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 801
DATË 22.10.21
PRISHTINË

KGJK.nr.291/2021
Datë: 18 tetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.24 dhe 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 19 dhe 21 të Rregullores nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në takimin 268-të, të mbajtur më datë 18 tetor 2021, merr këtë:

VENDIM

I. Autorizohet Komisioni për Administrimin e Gjykatave të analizoj dhe rishqyrtoj në tërësi Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

II. Autorizohet Komisioni për Çështje Normative të shqyrtoj propozimet e Komisionit për Administrimin e Gjykatave për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore apo ri-draftim të udhëzimit.

III. Vendimi hyn në fuqi më 18 tetor 2021.

Arsyetim

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me qëllim të unifikimit të taksave gjyqësor me vendimin KGJK. Nr. 54/2017, të datës 15 mars 2017, ka miratuar Udhëzimin Administrativ (Nr. 01/2017) për Unifikimin e Taksave Gjyqësore me të cilin përcaktohen taksat gjyqësore në procedurat gjyqësore që zhvillohen në gjykatat e Republikës së Kosovë, mënyra e pagesës dhe lartësia e tyre.

Me gjithë përpjekjen e Këshillit që përmes këtij udhëzimi të përfshihen të gjitha procedurat gjyqësorë në mënyrë që të bëhet unifikimi i taksave gjyqësore në tërë territorin e vendit tonë, gjatë zbatimit në praktikë të këtij udhëzimi është vërejtur që ka mungesa në përcaktimin e taksave për disa çështje gjyqësore gjë që ka ndikuar në nevojën për plotësimin dhe ndryshimin e këtij Udhëzimi Administrativ. Prandaj, Këshilli me qëllim të eliminimit të mundësisë për inkasimin e taksave nga ana e gjykatave në mënyra të ndryshme, vendosi që fillimisht të autorizoj Komisionin për Administrimin e Gjykatave që në tërësi të bëjë një analizë edhe krahasimore me vendet e tjera,

duke i pasur parasysh standardet, si dhe këto propozime të i paraqiten Komisionit për Çështje Normative për shqyrtimin e nevojës që ky udhëzim të ndryshohet – plotësohet apo të ri-draftohet.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Komisionit për Administrimin e Gjykatave;*
- *Komisionit për Çështje Normative;*
- *Sekretariatit të KGJK-së, si dhe*
- *Arkivit.*